

ÇËSHËTJE TË TIPOLOGJIZIMIT TË KRITIKËS LETRARE SHQIPE

ARBEN HOXHA
Instituti Albanologjik, Prishtinë, Kosovë

AKTET V, 3: 619-623, 2012

PËRMBLEDHJE

Metodologjia përbën sistemin e rregullave dhe të mënyrave të hulumtimi shkencor. Metodologjia, si teori e njohjes mbi metodat, bën standardizimin e të gjitha proceduarve, si: të grumbullimit të fakteve empirike që përbëjnë lëndën e hulumtimit; të mënyrës së sistematizimit të tyre; të metodave të interpretimit dhe të nxjerrjes së konkluzioneve. Një instrument i domosdoshëm metodologjike për zotërimin e ligjësorive më të përgjithshme, me anë të së cilit mund të identifikohen etapat e racionalitetit dhe të objektivitetit shkencor që e përshkojnë procesin e zgjidhjes së problemeve në një fushë të caktuar të dijes - është tipologjizimi. Në këtë punim, mbi bazën e kriterit metodologjik të problemeve me të cilat është marrë kritika letrare shqipe, do të merremi me çështjen e tipologjisë së kritikës letrare, si një nga çështjet e rëndësime teorike e metodologjike për ndriçimin e procesit të zhvillimit të kritikës letrare shqipe pas LIIB e këtej.

Fjalët kyçe: metodologjia, kriteri, tipologjia, sistemet epistemike letrare, problemet

SUMMARY

The methodology is the system of rules and ways of scientific research. Methodology, as a theory of knowledge on methods, makes the standardization of all procedures, such as: the collection of empirical fact that consist the subject of research, the way of their systematizing, the methods of interpretation and extraction of conclusions. An indispensable tool for mastering of general rules, through which might be identified the stages of rationality and scientific objectivity that permeate the process of solving problems in a given field of knowledge – as it is typologization. In this paper, on the basis of methodological criteria problems obtained by Albanian literary criticism, we will deal with the issue of typology of literary criticism, as one of the methodological and theoretical issues for enlightening the process of developing the Albanian literary criticism after Second World War onward..

Key words: methodology, criteria, typology, literary epistemic systems, problems

1. HYRJE

Shkalla e zhvillimit të një shkence përcaktohet prej masës dhe cilësisë së zgjidhjes së problemeve me të cilat ajo përballet. Në të vërtetë, lëndën dhe gamën e një shkence e formojnë problemet me të cilat ajo synon t'i zgjidh. Zgjidhja e suksesshme e një problemi hap shtegun për shtruarjen e problemeve të reja shkencore. Megjithatë, shtruarja e problemeve dhe zgjidhja e tyre në vetvete nuk përbën kushtin mjaftueshëm me anë të së cilit mund të vlerësohet zhvillimi i një shkence. Zhvillimi përcaktohet jo vetëm prej akteve të shtruarjes së problemeve brenda një shkence, por, në radhë të

parë, prej vlerësimit dhe përkufizimit objektiv që i bëhet natyrës dhe rëndësisë së vetë problemit në raport me perspektiven e zhvillimit të shkencës. Metodologjia është ajo disiplinë njohëse shkencore e cila na ndihmon që ta kuptojmë qëllimin (natyrën e problemit të shtruar për zgjidhje) dhe rezultatin e njohjes (qëndrueshmërinë e zgjidhjes së atij problemi), por edhe mënyrën se si është arritur ai (rezultati). Në këtë mënyrë metodologjia na bën të mundur që t'i nxjerrim në pah dallimet që ekzistojnë ndërmjet lëndëve të ndryshme të hulumtimit si dhe vëllimin e problemeve të zgjidhura në një fushë të caktuar të dijes (Filkorn, 1987: 319-321).

Në këtë punim zhvillimin e kritikës letrare shqipe do ta vështrojmë në bazë të problemeve që ajo ka shtruar për zgjidhje në faza të ndryshme dhe prej cilësisë e qëndrueshmërisë së zgjidhjeve që ajo ka ofruar për to.

2. PËRCAKTIMI I NATYRËS SË PROBLEMEVE

Në bazë të natyrës së problemeve dhe rrugëve që janë përdorur për zgjidhjen e tyre, pas Luftës së Dytë Botërore, mund të themi se kritika letrare shqipe do të merr dy pozicione themelore epistemologjike: në etapën e parë të zhvillimi të saj (që fillon nga viti 1945 e deri në mesin e viteve '60-të) – për shkak se do ta vlerësojë në shkallë të lartë rëndësinë e zotërimit të të dhënave dhe të fakteve që lidhen me dokumentet, gjenezën e veprave dhe me jetën e shkrimtarëve – kritika letrare do të fokusohet në tipin e problemeve të *natyrës empirike*, për zgjidhjen e së cilave ajo do të udhëhiqet prej paradigmes epistemologjike empiriciste. Ndërkaq, në etapën e dytë të zhvillimit (që fillon nga mesi i viteve 60-të, por që konsolidimin e saj e arrin në vitet '70-të, për të vazhduar më tej gjatë tërë gjysmës së dytë të shek. XX), kritika letrare do të shtrojë tipin e *probleme të natyrës konceptuale –teorike*, me ç'rast për zgjidhjen e tyre ajo do të zbatojë *paradigmën epistemologjike të racionalizmit kritik*. Nëpërmjet një paradigme e tillë faktet dhe vlerat – për shkak të kontekstit të ri teorik-konceptual në të cilat tashmë ato do të ndodhen – do të marrin kuptime dhe dimensione të reja vlerësuese në rrafshin historik, artistik dhe estetik të tyre.

Karakteristikë kryesore e zhvillimit të kritikës letrare sipas natyrës së problemeve të shtruara për zgjidhje në këto dy etapa të mëdha është shndërrimi i saj nga të qëniti kritikë përshkruese-empirike, në kritikë interpretuese, shpjeguese e vlerësuese sipas kriterëve estetikë e artistikë të prirjeve, të rrjedhave, të strukturave të fenomeneve dhe veprave letrare. Në qoftë se në etapën e parë do të mbizotërojë përpjekja për të klasifikuar të vërtetat objektive të pretenduara në bazë të fakteve dhe të dhënave empirike; në etapën e dytë, ndërkaq, do të mbizotërojë përpjekja për krijimin e një kuadri teorik apo një

paradigme gjithëpërfshirëse, ku letërsia shqipe do të trajtohet si letërsi e njësishtme në gjerësinë dhe thellësinë saj, në unitetit e të kundërtave të veçorive dhe përbërësve të saj tematikë, strukturalë, historikë, stilistikë, kompozicionalë, etj., pavarësisht hapësirë gjeografike shqipfolëse ku do të shfaqen ato.

Në kritikën letrare shqipe këto dy paradigma do ta përcaktojnë strukturën e metodologjisë së hulumtimit, e cila, në rastin e parë, hulumtimeve do t'u jep karakter kontekstual-diakronik dhe në rastin tjetër karakter diakronik-sinkronik tekstual. Produkt i këtyre përmbajtjeve epistemologjike janë *sistemet epistemike letrare*³⁶, si struktura metodologjike të hulumtimit.

3. TIPOLOGJIA: TRI SISTEMET EPISTEMIKE LETRARE

Prej ecurisë së zhvillimit të kritikës letrare shqipe pas Luftës së Dytë Botërore e këtej, gjithnjë duke u bazuar në kriterin e problemeve me të cilat ajo do të merret, mund të dallojmë tri sisteme epistemike letrare:

1) Sistemin epistemik letrar pozitivist, i cili degëzohet në dy lloje:

- a) në llojin natyralist-esencialist, dhe
- b) në llojin historik-shoqëror;

2) Sistemin epistemik letrar imanent, i cili, po ashtu, degëzohet në dy lloje:

- a) në llojin tematik – subjektivist
- b) në llojin struktural – objektivist; dhe

3) Sistemi epistemik letrar integral

Sistemi epistemik pozitivist letrar i llojit natyralist-esencialist, do të bazohet në konceptin se veprat e ndryshme, fenomenet dhe rrjedhat letrare, ashtu si edhe dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet tyre, s'janë gjë tjetër pos epifenomene që mbështetën në lidhjen shkakësore me realitetin natyror (në gjeografinë, biologjinë dhe karakterologjinë e popujve).

³⁶ Me togfjalëshin terminologjik *sistemet epistemike letrare kuptojmë* tërësinë e lidhjeve dhe rregullimit të teorive dhe të metodave, të fakteve shkencore dhe të ligjeve shkencore, të cilat janë krijuar dhe funksionojnë sipas një parimi të përbashkët në punë të zgjidhjes së problemeve të caktuara.

Përfaqësues tipik i shkrimit të kritikës letrare, që do të bazohet në llojin natyralist-esencialist të sistemit epistemik pozitivist, në fazën e parë të zhvillimit të strukturës epistemologjike të kritikës letrare shqipe pas vitit 1945 e deri në mesin e viteve '60-të – është Eqrem Çabej (1994), ndërkaq përfaqësues i llojit historik-shoqëror të sistemit epistemik pozitivist është Dhimitër Shuteriqi (1979, 1987).

Këto dy lloje sistemesh epistemike pozitiviste (natyraliste-esencialiste dhe historike-shoqëror) në kritikën letrare shqipe, në rrafshin logjik të funksionimit të tyre, do t'i bashkojë metoda deduktive e hulumtimit të së vërtetës dhe vërtetësisë së fakteve të grumbulluara, si dhe kërkesa për sistematizimin e tyre në mënyrë kronologjike. Që të dy këto lloje të sistemit epistemik pozitivist, në bazë të parimeve të tyre metodologjike, kritikën letrare shqipe do ta orientojnë në dimensionin diakronik për zotërimin e objektit të njohjes letrar.

Për ndryshim nga faza e parë (1945-1960), në fazën e dytë të zhvillimit të kritikës letrare shqipe (1960-1980) kemi avancim të sistemit epistemik pozitivist në pikëpamje të rritës së vëllimit të problemeve me të cilat ai do të merret, por jo edhe zhvendosje të vëmendjes në problemet me natyrë më të përbërë, probleme këto për zgjidhjen e të cilëve do të kërkoheshin kategori dhe instrumente të reja epistemologjike. Prandaj, në këtë etapë të zhvillimit epistemik pozitivist nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë avancim cilësor të përbërësve të vetë sistemit (zgjerimit me kategori të reja, me teori dhe me metoda të reja), si instrumente për zotërimin e atyre objektivave.

Ashtu sikur sistemi epistemik pozitivist, ashtu edhe sistemi epistemik imanent, në kuadër të strukturës së zhvillimit epistemologjik të kritikës letrare shqipe, nuk do të zbatohet mbi bazën e një postulati metodologjik të njëjtësishëm, por do të degëzohet në dy postulate metodologjike:

a) postulatit, i cili njohjen letrare e trajton si produkt të perceptimeve subjektive ndijore në njërën, dhe intuitës subjektive, në anën tjetër; dhe

b) postulatit, i cili njohjen letrare e trajton si produkt të refleksioneve racionale objektivist.

Emërues i përbashkët i zbatuesve të sistemit epistemik të llojit tematik-subjektivist është subjektivizmi, si botëkuptim dhe si parim epistemologjik letrar. Ndërkaq, dallimet ndërmjet tyre konsistojnë në burimet njohëse, prej së cilave do të manifestohen pikëpamjet e tyre subjektivist mbi botën në përgjithësi, dhe për letërsinë, në veçanti. Kështu mund të themi se në qoftë se Ali Aliu (1980) si burim për njohjen letrare do t'i shfrytëzojë perceptimet ndijore subjektive, me ç'rast konturat e objekti të njohjes do t'ia nënshtrojë strukturës së përvojës perceptimore ndijore të tij, si subjekt njohës; Mensur Raifi (1979), Ibrahim Rugova (1986, 1987), dhe Sabri Hamiti (1987, 1989), ndërkaq, si burim për njohjen letrare do ta shfrytëzojnë intuitën, me ç'rast, si subjekte të njohjes, me qëllim që të zotërohen "esencat" dhe "idetë" e objektit të njohjes, raportin me objektin e njohjes letrare do ta vendosin në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa ndërmjetësimin dhe pa vendosjen paraprake të raporteve ndërmjet formave logjike të të menduarit, si me: konceptet, analizën, deduksionin, induksionin, argumentet, sintezën, përgjithësimin etj.

Përkundër tipit të kritikës letrare të sistemit epistemik imanent të llojit tematik-subjektivist, i cili – i bazuar në konceptin metodologjik sipas të cilit është subjekti njohës ai që e përcakton natyrën e objekti të njohjes – në qendër të interpretimit, si procedim metodologjik, do ta vejë temën dhe idetë e veprës letrare; tipi i kritikës letrare i sistemit imanent të llojit struktural-objektivist, i cili – i udhëhequr prej konceptit metodologjik sipas të cilit është natyra e objektit të njohjes ajo që i përcakton mjetet dhe veprimin njohës të subjektit të njohjes – duke shfrytëzuar metodën formale të analizës, në qendër të interpretimit, si procedim metodologjik, do ta vejë strukturën e veprës letrare artistike. Përfaqësues reprezentativë të tipit të kritikës letrare të sistemit imanent të llojit struktural-objektivist mund t'i konsiderojmë këta autorë: Sefedin Fetiun (1992), Bajram Krasniqin (1980), dhe Basri Çapriqin (1990).

Në qoftë se zbatuesit e tipit të kritikës letrare të sistemit epistemik imanent të llojit tematik-subjektivist për burim të njohjes do ta përdorin intuitën, zbatuesit e tipit të kritikës letrare të sistemit epistemik imanent të llojit struktural-objektivist për burim të njohjes do ta përdorin logjikën matematikore. Në qoftë se të parët specifikën e letërsisë do ta kërkojnë në “esencat” e ideve dhe temave që dalin prej sistemit të saj; të dytët ndërkaq, specifikën e letërsisë do ta kërkojnë në strukturën e brendshme, në përbërësit e sistemit të saj.

Mes këtyre dy skajshmërive parimesh metodologjike të sistemit epistemik pozitivist, në njërën, dhe të sistemit epistemik imanent, në anën tjetër, në gjysmën e dytë të shek. XX, qëndron tipi i kritikës letrare që bazohet në parimin dialektik metodologjik, sipas të cilit vepra letrare është e varur si prodhim historik dhe e pavarur si qenie artistike. Një parim i tillë, – brenda kuadrit të kritikës letrare shqipe të gjysmës së dytë të shek. XX – do të luaj rol të rëndësishëm në punë të zgjerimit të përmbajtjes së objektivave njohës letrare si dhe në avancimin e racionalitetit dhe të objektivitetit shkencor të kritikës letrare shqipe.

Në ç’rrugë dhe me çfarë përmbajtjes të reja sistemi epistemik integral do t’i zgjerojë objektivat njohëse dhe vetë strukturën e kritikës letrare shqipe?

Janë dy etapa që do ta përshkojnë zhvillimin e sistemin epistemik integral, e me këtë edhe strukturën e zhvillimit epistemologjik të kritikës letrare shqipe:

a) etapa e parë, në të cilën do të rishqyrtohet e kontestohet struktura e sistemit epistemik pozitivist dhe do të ofrohen zgjidhjet për problemet që dalin prej saj; dhe

b) etapa e shtruarjes për zgjidhje të problemeve të reja.

Dinamika e zhvillimit të kritikës letrare, fillimisht, do të përcaktohet prej nivelit të shqyrtimit kritik e të argumentuar që do t’i bëhet sistemit epistemik pozitivist. Kontestimi i hierarkisë së vjetër të problemeve, që do t’i shtrojë për zgjidhje sistemi epistemik pozitivist, të shumtën e rasteve, do të realizohet nëpërmjet shqyrtimeve

kritike-teorike që sistemi epistemik integral do t’i bëjë teorisë së sistemit epistemik pozitivist, prej të cilës do të nxiten për shtruarje ato probleme dhe prej zgjidhjeve të reja që ai do të ofrojë.

Kështu, bie fjala, teorinë dhe parimin metodologjik të kritikës letrare të sistemit epistemik pozitivist, sipas të cilit letërsia është produkt dhe në varësi të plotë me produktet tjera historike-shoqërore në jetën e një populli dhe se ndërmyet tyre nuk ekziston kurrfarë diferencimi, në praktikën e zhvillimit të kritikës letrare shqipe sistemi epistemik integral do ta kontestojë dhe eliminojë nëpërmjet teorisë së poetikës strukturale dhe parimit dialektik metodologjik, i cili letërsinë i sheh si entitet në vete, por edhe në ndërvarësi me faktorët historik-shoqëror dhe me sistemet tjera kulturore. Një parim i tillë do ta ndryshojë paradigmen teorike në punë të përkufizimit të natyrës dhe të funksionit të letërsisë. Në këtë mënyrë, vendin e tipit të problemeve të natyrës empirike tani do ta zë tipi i problemeve konceptuale-teorike.

Kuadri i ri teorik dhe parimi i ri metodologjik do ta përcaktojë edhe kuadrin e ri empirik të hulumtimit të fenomeneve letrare dhe anasjelltas. Vepra letrar, nën dritën e një parimi të tillë, nuk do të trajtohet më në bazë të konceptit për funksionin utilitar të letërsisë, por, para së gjithash, në dritën e funksionit estetik të saj.

Parimi dialektik metodologjik, duke përdorur si “medium të vetin” sistemin epistemik letrar integral do të ndikojë në përafrimin dhe “njësimin” e përvojave të ndryshme të traditës së hulumtimit dhe njohjes letrare, në dukje përjashtuese ndaj njëra tjetrës, si: ato të pozitivizmit, të formalizmit rus, strukturalizmit, semiologjisë, metodës krahasimtare, metodës receptive etj. Sistemi epistemik integral në kritikën letrare shqipe lidhet me emrin e Rexhep Qosjes (1968, 1984-1986), si themelues i tij, dhe pasohet nga një varg studiuesish të tjerë, si: Agim Vinca (1985), Sefedin Fetiu (1984), Bajram Krasniqi (1985), Agim Deva (1982), Emin Kabashi (1994) etj.

Për shkak se ideali i modernizimit dhe evropëizimit të kritikës letrare shqipe – që do të

burojë prej sistemit epistemik integral – nuk do të bazohet as në kompleksin e inferioritetit ndaj kulturave më të mëdha e as në kompleksin e superioritetit dhe në ndjenjën e vetëmjaftueshmërisë dhe në ideologjinë krahinariste, do të nxitë procesin e kalimit të kulturës shqiptare nga faza e heteronomisë në fazën e autonomisë së zhvillimit të saj.

4. PËRFUNDIM

Në kushtet në të cilat ka kaluar zhvillimi i kulturës shqiptare, në përgjithësi, është krejtësisht e natyrshme që struktura e zhvillimit epistemologjik të kritikës letrare shqipe të mos i nënshtrohet skemës triadike hegeliane: tezë – antitezë dhe sintezë, në të cilën teza (sistemi epistemik pozitivist) dhe antiteza (sistemi epistemik imanent) nuk kanë asgjë të përbashkët njëra me tjetrën, ndërkaq kontradiktat e tyre do t'i shuajë vetëm sinteza (sistemi epistemik integral). Mund të themi se për shkak të karakterit atipik të zhvillimit epistemologjik të kritikës letrare shqipe, sistemi epistemik integral, si akt i mohimit dialektik dhe si moment i lidhjes në zhvillim, do të përfshijë në vete momente të zhdukjes dhe momentet e mbajtjes së cilësive të sistemit epistemik pozitivist, në njërën, si dhe momente të pranimit dhe refuzimit të cilësive të sistemit epistemik imanent të llojit struktural-objektivist, në anën tjetër.

Mu për këtë arsye, mund të themi se sistemi epistemik imanent i llojit tematik-subjektivist – kohësisht i shfaqur pas sistemit epistemik integral – në kuadër të strukturës së zhvillimit epistemologjik të kritikës letrare shqipe nuk do ta ketë as funksionin e antitezës e aq më pak të sintezës. Ai do të jetë e shtrënguar të vihet rrotull procesit dhe, të shumtën e kohës, në kahe të kundërt me progresin e kritikës letrare.

BIBLIOGRAFIA

ALIU, Ali (1971): *Kërkime*, Rilindja, Prishtinë.
 ÇABEJ, Eqrem (1994): *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, MÇM, Tiranë.

ÇAPRIQI Basri (1990): *Mikrostruktura e tekstit poetik*, Rilindja, Prishtinë.

DEVA, Agim (1982): *Poezia për fëmijë (1872-1980)*, Rilindja, Prishtinë.

FETIU, Sefedin (1992): *Poetika e romanit shqiptar (1952-1977)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

FETIU, Sefedin (1984): *Vepra e Migjenit dhe kritika e saj*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

FILKORN, Vojtech (1987), Strong and weak methods: *Logic, methodology and philosophy of science VIII*, New York.

HAMITI, Sabri (1987): *Njeriu kryengritës (Hivzi Sulejmani: vepra letrare)*, Rilindja, Prishtinë.

HAMITI, Sabri (1989): *Vetëdija letrare*, Rilindja, Prishtinë.

KABASHI, Emin (1994): *Poetika e poemave të Jeronim de Radës*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

KRASNIQI, Bajram (1980): "Poetika e prozës së Ismail Kadares", në *Komunikime Letrare*, Rilindja, Prishtinë.

KRASNIQI, Bajram (1985): *Poetika e romanit historik shqiptar*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.

LOGIC, methodology and philosophy of science VIII (1987), New York.

QOSJA, Rexhep (1968): *Dialogje me shkrimtarë*, Rilindja, Prishtinë.

QOSJA, Rexhep (1984-1986): *Historia e letërsisë shqipe – Romantizmi I, II, III*, Rilindja, Prishtinë.

RAIFI, Mensur (1979): *Fan S. Noli dhe Migjeni*, Rilindja, Prishtinë.

RUGOVA, Ibrahim (1986): *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare (1504-1983)*, Rilindja, Prishtinë.

RUGOVA, Ibrahim (1987): *Refuzimi estetik*, Rilindja, Prishtinë.

SHUTERIQI, Dhimitër (1979): *Mbi Barletin dhe shkrime të tjera*, Naim Frashëri, Tiranë.

SHUTERIQI, Dhimitër (1987): *Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera*, naim Frashëri, Tiranë..